

**PERMBLEDHJE JOTEKNIKE
E VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS
PËR AKTIVITETIN
MAGAZINIM KIMIKATESH**

**Shoqeria: “Newpark Drilling Fluids SpA Albania Branch” Dege e shoqërisë së huaj
Vendodhja e aktivitetit : Lagjja 14, Shkozet, Durres**

Tirane 2020

PERMBAJTJA

- **Hyrje**
- **Informacion per qellimin e VNM dhe metodiken e zbatuar**
- **Pershkrimi i projektit**
- **Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi**
- **Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij**
- **Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit perfshire ndikimet ne biodiversitet, uje, toke dhe ajer**
- **Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe per prodhimin e mbetjeve**
- **Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara**
- **Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negativ ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te**
- **Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar te siperfaqes ne gjendjen e meparshme si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin**
- **Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis**
- **Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)**

HYRJE

Shoqëria “Newpark Drilling Fluids SpA Albania Branch” Dege e shoqërisë së huaj është regjistruar pranë QKB-se me datë 13/03/2014 me numer NIPTI L41513011U, dhe fushe të veprimtarisë “Punime dhe tregti, si për llogari të vet dhe për të tretet, për çdo produkt kimik ose mineral i cili është i nevojshëm për kryerjen e shpimeve për të vijuar me kërkimet e hidrokarbureve, të ujërave dhe produkteve gjeotermike: ekzekutimin e punëve ndihmëse në lidhje me shpimin e puseve; huazimin e shërbimeve të asistencës dhe konsulentëve teknikë; tregtimin dhe dhenien me qira të mjeteve dhe paisjeve teknike që kanë lidhje ose i referohen aktiviteteve të mëparshme”.

Raporti Paraprak i Vlerësimit të ndikimit në mjedis hartohet me kërkesë të subjektit për ushtrimin e aktivitetit Magazinim kimikatesh, me vendodhje në Shkozë, Durrës.

Raporti synon të japë një informacion të detajuar dhe të besueshëm lidhur me ndikimin mjedisor të projektit të propozuar në përdorimin e tokës, efektet lidhur me ndikimet në florën, faunën, burimet e ujit, shkarkimet në tokë, ujë, si dhe çdo ndikim social ekonomik në punësimin lokal, përmirësimin e infrastrukturës dhe ndikimeve të tjera të rëndësishme mjedisore ose sociale, përfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutëse të ndikimeve të projektit në mjedisin fizik dhe social me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qëndrueshmërisë së mjedisit nëpërmjet :

- Marrjes në konsideratë të çështjeve të mjedisit në fazën e përgatitjes së projektit.
- Shqyrtimit të alternativave të ndryshme brenda projektit.
- Të japë një gjendje sa më reale, nga pikepamja e ndikimit të aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizën e faktoreve pozitive e negative mjedisore, përcaktimin e masave zbutëse për reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes në dukje dhe vlerësimin cilësor të ndikimeve në mjedis të projektit.
- Propozime të masave zbutëse të ndikimit në projekt.

Për këto probleme u bë mbikqyrja e terrenit në të gjithë zonën, duke kryer vëzhgime të ndryshme, si dhe të biodiversitetit.

Në raport jepet statusi i territorit, korniza ligjore e tij, mjedisi biofizik, gjeologjia e rajonit, gjeologjia e zonës, hidrogeologjia.

Mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk është i rëndësishëm vetëm për njerezit por është thelbësor dhe i nevojshëm për të gjitha qeniet në tokë. Njerezit duhet të kuptojnë se si përdorimi i burimeve mjedisore dhe përfitimet që vijnë nga ato të mos demtohen por të jete e mundur të përfitohet sot dhe në të ardhmen.

Termi mjedis dhe burime natyrore përdoren shpesh por jo gjithmone me kuptimin e qartë që i perkufizon. Burimet natyrore i referohen burimeve të tokës, ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore, ajrit që rrethon tokën, çdo gjë që rritet në tokë apo det si dhe burimet që gjenden nëntokë si psh mineralet. Mjedisi është me gjithpërfshirës, çdo gjë që na rrethon.

Thjesht duke përdorur burimet natyrore në rrezikojmë në mbipërdorimin dhe shërimin e tyre. Shërimi i burimeve natyrore është një nga problemet thelbësor të rregullimit të mjedisit. Në të përfshihet shërimi i ujit, mineraleve përfshirë dhe lëndet fosile si dhe shumë burime të tjera.

Çdo veprimtari e kryer nga njeriu shoqërohet edhe me impakt në mjedis. Pra impakti mjedisor i referohet ndryshimit të mjedisit natyror nga aktiviteti njerëzor.

Kemi dy tipe të impaktit mjedisor

- Shërimi i burimeve

- Ndotja

Ne menyre qe te shmangen keto probleme njerezimi duhet te mesoj se si te menaxhohen burimet natyrore ne menyre te qendrueshme. Pra zhvillimi i qendrueshem i burimeve natyrore nuk eshte gje tjeter vecse perdorimi i tyre ne menyre ekonomike nga brezat e sotem per ti len keto burime te perdoren edhe nga brezat qe do te vijne.

Qendrueshmeria perfshin menaxhimin e gjithë perberesve dhe burimeve natyrore e njerezore me qellim qe te pasurohen me kalimin e kohes dhe te sigurohet nje mireqenie per te gjithë. Zhvillimi i qendrueshem nuk i pranon politikat te cilat cojne ne uljen e bazes prodhuese dhe lene gjeneratat e ardhshme me prespektiva me te ulta (te varfera) dhe/ose rreziqe me te medha se te tonat. Teknologjite qe kontribuojne ne zhvillimin e qendrueshem perfshijne kontrollin e ndotjes, prodhimin e energjise se riciklueshme, rikuperim burimesh dhe riciklim, menaxhim burimesh dhe kerkime shkencore.

Problemet mjedisore ne vendin tone lidhen me ndotjen e ajrit ne qytetet kryesore , ndotja e ujit e cila vjen nga shkarkimi i ujerave te ndotura pa u trajtuar fillimisht dhe mbetjet urbane te cilat jo te gjitha depozitohen ne vendet e caktuara.

INFORMACION PER QELLIMIN E VNM DHE METODIKEN E ZBATUAR

a-Pershkrim te qellimit dhe objektivave te VNM

Vleresimi i ndikimit ne mjedis eshte nje proces ne vazhdimesi i aktivitetit dhe siguron se ndikimet mjedisore te rendesishme, sinjifikante jane vleresuar dhe marre ne konsiderate ne menyre te kenaqshme ne planifikim, projektim, zbatim te aktivitetit qe do te zhvillohet.

Qellimi i VNM- se

Qellimi i hartimit te raportit te VNM-se eshte percaktimi i efekteve negative dhe pozitive te aktivitetit dhe masat e duhura per permiresimin dhe zvogelimin e ndikimeve ne mjedis si rezultat i zhvillimit te projektit **Magazinin i kimikateve.**

VNM nuk do te mbuloj çdo aspekt te nje efekti mjedisor te projektit, me te njejtin nivel detajesh. Theksi do te vihet ne ndikimet kryesore qe shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu nje synim tjeter eshte te percaktoje e rekomandoje masat teknike- organizative per zbutjen e aneve negative qe mund te krijohen gjate zhvillimit te aktivitetit dhe te jape informacion per vendim-marresit per pasojat mjedisore te aktiviteteteve te propozuara.

VNM perfshin gjithashtu parashikimin dhe planifikimin e masave zbutese te ndikimeve te projektit ne mjedisin fizik dhe social me qellim permiresimin e cilesise dhe qendrushmerise se mjedisit nepermjet :

- Marrjes ne konsiderate te ndikimeve te mjedisit qe ne fazen e pergatitjes se propozimeve ne projekt.
- Shqyrtimit te alternativave te ndryshme brenda projektit.
- Te jape nje gjendje sa me reale, nga pikepamja e ndikimit ne mjedis te aktivitetit mbi mjedisin human.
- Analizes se faktoreve pozitive e negative mjedisore dhe te masave zbutese per Reduktimin e ndikimeve negative.
- Nxjerrjes ne dukje dhe vleresimi cilesor me pika te ndikimeve ne mjedis te projektit.
- Propozime te masave zbutese te ndikimit ne mjedis te projektit.

Objektivat e VNM

Objektivat e hartimit të VNM- se konsistojnë në evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve në mjedis dhe masat tekniko-organizative për një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit, gjatë kryerjes së aktivitetit deri në përfundim të tij dhe rehabilitimin e hapësirës përreth objektit.

Me këtë studim informojmë organet vendim-marrës, mbi ndikimet në mjedis dhe përfitimet e projektit të propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qëndrueshëm duke siguruar që zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesën e komunitet si dhe të njerezëve që lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

Objektivat e tjera të studimit të paraqitur janë.

- Përmirësimet mjedisore të zonës ku zbatohet projekti dhe rreth saj.
- Përdorimin e burimeve natyrore në mënyrën të qëndrueshme ku respektohen dhe Kërkesat e komunitetit të zonës për rreth.
- Identifikon masat e duhura për zvogelimin e ndikimeve të mundshme potenciale negative të projektit të zbatuar
- Lehtëson informimin e organeve vendim-marrëse, duke përfshirë vendosjen e termave dhe kushteve mjedisore për zbatimin e projektit apo propozimit.
- Mbrojtjen e shëndetit të njeriut.
- Parashikon dhe përjashton ndryshimet e pakthyeshme dhe dëmtimet serioze të mjedisit.
- Ruan dhe mbron burimet natyrore, peziazhet e natyrës dhe komponentet përberës të ekosistemeve.
- Përmirëson aspektet sociale të projektit.

b) Përshkrim i përmbledhur i kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin

Në Shqipëri fillësat e legjislacionit mjedisor shfaqen në vitin 1993, vit në të cilin u hartua plani i parë i veprimit në fushën mjedisore, që përben dokumentin e parë zyrtar shqiptar mbi politikën mjedisore në vend. Ky plan veprimi kombëtar parashikonte se qeveria duhet të krijojë kuadrin ligjor, ekonomik dhe institucional për zgjidhjen e çështjeve mjedisore. Periudhën nga ky vit deri në miratimin e Kushtetutës në vitin 1998 mund ta konsiderojmë si etapën e parë të zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit. Mbas vitit 1998 e në vijim është periudha e dytë e zhvillimit të së drejtës shqiptare të mjedisit, e cila ka si tipar kryesor prirjen e përafërimit me legjislacionin e Bashkimit Europian për mjedisin. Kuadri ligjor mjedisor shqiptar është në përsosje dhe pasurim të vazhdueshëm dhe zhvillimi i tij nuk është len rasteies, por ka si model dhe drejtues legjislacionin europian të mjedisit. Duke qenë se kushtetutat ravigëzojnë drejtimit e rregullimeve të ardhshme dhe me të hollësishme që realizohen fillimisht me ligje dhe më pas me akte nenligjore edhe në rastin e vendit të Kushtetutës përben një fillese dhe baze të rëndësishme lidhur me rolin që ka mjedisi për shoqërinë dhe shtetin të. Nisur nga përmbajtja e nënëve të Kushtetutës lidhur me fushën mjedisore mund të pohojmë se fryma e Kushtetutës sone është në përputhje me atë të shumë kushtetutave të vendeve të tjera demokratike që u kushtojnë rëndësi të një niveli më të lartë disa parimeve mjedisore, duke i ngritur ato në nivelin e ligjit themelor të shtetit, sic janë e drejta për informimin e qytetarëve dhe angazhimi e përgjegjësia për një mjedis të përshtatshëm për të jetuar jo vetëm brezat e sotëm por edhe ata në të ardhmen.

- Ligji nr.52/2020 date 30.04.2020 per nje ndryshim ne ligjin nr. 10 448 date 14.07.2011 « Per Lejet e Mjedisit »
- Ligjnr.53/2020 date 30.04.2020 per nje ndryshim ne Ligji Nr.10 431,date 09.06.2011 “ Per Mbrojtjen e Mjedisit”
- VKM nr.686 date 29.7.2015 « Per miratimin e rregullave , te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis (VNM) dhe procedures se transferimit te vendimit e Deklarates Mjedisore »
- Ligji nr. 10440 date 07.07.2011 « Per vleresimin e ndikimit ne mjedis »
- VKM nr. 435 date 12.09.2015 « Per miratimin e normave te shkarkimeve ne ajer ne Republiken e Shqiperise »
- VKM nr. 575 date 24.06.2015 “Per miratimin e kerkesave per menaxhimin e mbetjeve inerte”
- VKM nr.419 date 25.6.2014 « Per miratimin e kerkesave te posacme per shqyrtimin e kerkesave per leje mjedisi te tipave A,B dhe C per transferimin e lejeve nga nje subject te tjetri, te kushteve per lejet respektive te mjedisit si dhe rregullave te hollesishme per shyrtrimin e tyre nga autoritetet kompetente deri ne leshimin e ketyre lejeve nga QKLja.
- Vendim Nr. 247, datë 30.4.2014 “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”
- VKM nr. 229 date 23.04.2014 “ Per miratimin e rregullave per transferimin e mbetjeve jo te rrezikshme dhe te dokumentit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme”.
- VKM nr.371 date 11.06.2014 ‘Per percaktimin e rregullave per dorezimin e mbetjeve te rrezikshme dhe miratimin e dokumentit te dorezimit te mbetjeve te rrezikshme”
- Vendim nr. 13 date 4.1.2013 « Per miratimin e rregullave, te pergjegjesive e te afateve per zhvillimin e procedures se vleresimit te ndikimit ne mjedis »
- VKM nr. 765 date 07.11.2012 “Per miratimin e rregullave per grumbullimin e diferencuar dhe trajtimin e vajrave te perdorura”
- Ligji nr. 10 463 date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve”
- Ligji nr.10 440 date 07.07.2011 « Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis »
- Ligj nr. 10266 date 15.04.2010 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja” per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin nr. 8897 dt. 16.05.2002 “Per mbrojtjen e ajrit nga ndotja”
- Udhezimin nr.12 date 15.06.2010 per disa ndryshime ne Udhezim nr. 6527 date 24.12.2004 “Mbi Vlerat e lejueshme te elementeve ndotes te ajrit ne mjedis nga shkarkimet e gazrave dhe zhurmave shkaktuar nga mjetet rrugore dhe menytrat e kontrollit te tyre”
- Udhezim nr.1 date 03.03.2009 « Per detyrat e organeve mjedisore per te siguruar pjesemarrjen e publikut dhe te OJF-ve mjedisore ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis »
- Udhezim nr.3 date 19.11.2009 ‘Per metodologjine e raportit te VNM’
- Urdhrin e ministrit nr. 146 dt. 8.5.2007 ”Per miratimin e listes se kuqe te flores dhe faunes”
- Udhezimin nr 8 dt. 27.11.2007 “Per nivelin kufi te zhurmave ne mjedise te caktuara”
- VKM. Nr 177, datë 31.03.2005 “Për normat e lejuara të shkarkimeve të lëngta dhe kriteret e zonimit të mjediseve ujore pritëse”.
- VKM nr.99 date 18.2.2005 “Per miratimin e katalogut shqiptar te klasifikimit te mbetjeve”
- Ligji Nr 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Ligji Nr 9115, datë 27.02.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujrave të ndotur”. Të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

- Ligji nr. 9010 dt. 13.02.2003 “Per administrimin mjedisor te mbetjeve te ngurta”
- Ligji Nr 8906, datë 06.02.2002 “Për zonat e mbrojtura”. të ndryshuar dhe aktet nënligjore që rrjedhin prej tij.

c) Pershkrim i metodikes te zbatuar per hartimin e raportit te vnm

Studimi i vleresimit te ndikimit ne mjedis u orientua nga rendesia dhe madhesia e projektit, vendi ku ai do te zhvillohet , pasurite natyrore dhe humane te zones si dhe vlerat e vecanta te tyre ne identifikimin e ndikimeve negative dhe pozitive, marrja e masave zbutese duke patur parasysh edhe ruajtjen e interesave ekonomike te investitorit dhe masat orientuese pas mbylljes se projektit.

Reduktimi i ndikimeve negative eshte nderthurur edhe me ndikime te rendesishme pozitive sidomos ne perfitime direkte dhe indirekte mbi komunitetin.

Studimi strukturohet ne kater faza kryesore :

- 1.Ngritja e objektivave orientuese te V.N.M.
- 2.Mbledhja e materialit baze ekzistues dhe atij te formuluar enkas per kete projekt dhe seleksionimi i tyre per perdorim.
- 3.Verifikimi ne terren i te dhenave ekzistuese dhe mbledhja e te dhenave te mundshme biofizike dhe humane.
- 4.Hartimi i projektit bazuar ne legjislacionin Shqiptar si dhe kerkesave te organeve vendim-marrese dhe kontrollues te objekteve mjedisore ne nivel kombetar dhe lokal.

-PERSHKRIM I PROJEKTIT

- Qellimi i projektit

Qellimi i zhvillimit te aktivitetit eshte magazinimi i lendeve kimike per lengjet lares. Produktet e importuara do te magazinohen dhe do te perdoren ne sektorin e shpimit per lende hidrokarbure ku zhvillohet aktiviteti inxjerrjes se hidrokarbureve.

- Vendodhja e zhvillimit te projektit

Aktiviteti ndodhet ne Lagjja 14, Shkozet,Durres.

NR.	X	Y
1.	4578285.26	4374046.98
2.	4578314.62	4374026.59
3.	4578321.79	4374036.75
4.	4578291.3	4374057.69
Koordinata Gauss Kruger		



Aktiviteti importit dhe magazinimit te lendeve kimike per lengjet lares

Shoqeria “Newpark Drilling Fluids SpA Albania Branch” funksionon si nje staf teknik kompleks, me qellim te realizimit te aktivitetit te importit dhe me tej te perdorimit lendeve kimike per lengjet lares. Produktet e importuara i magazinon ne magazinën e marr me qira , dhe nje pjese te saj e kalon ne sektorin e shpimit per lende hidrokarbure atje ku zhvillohet aktiviteti.

Per realizimin e ketij aktiviteti, stafi i punesuar ka detyra te ndara qarte, pasi kemi te bejme me nje aktivitet, sa te dobishem po aq dhe delikat ne drejtim te mireperdorimit te ketyre lendeve kimike. Perdorimi i lendeve kimike per lengjet lares, krahas kontributit qe japin ne ne sektorin hidrokarbur, kane rezultuar te jene te demshem ne mjediset pritesë kur ato jane perdorur ne lloje dhe sasira te gabuara.

Krijimi i stafit teknik te kompletuar, eshte siguri e mbarevajtjes se biznesit, por nga ana tjeter eshte garanci per te evituar fenomenet negative te mundeshme qe mund te krijohen nga manaxhimi pa kompetece profesionale, dhe pikerisht:

- Siguria e importeve te lendeve kimike,
- Kontrolli i sasive te nevojshme,
- Evitimi i krijimit te stoqeve,
- Plotesimi me informacionin e domosdoshem teknik (etiketen e perdorimit dhe menyren e aplikimit),
- Njohja e tregut dhe realizimi i marketingut cilesor,
- Shperndarja e shpejte, e sigurte

Magazinimi i preparative kimike ka qellim prodhimin e Fluideve te Shpimit.

Baltë Shpimi me Bazë Ujë

Balta e shpimit me bazë uji zakonisht përbëhet nga argjila bentonite (xhel) me aditivë si sulfati i bariumi (barite), karbonat kalciumi (gips) ose hematite. Një agjent trashës si barite shtohet për të rritur dendësinë e përgjithshme të lëngjeve të shpimit me qëllim që të ruhet presioni i mjaftueshëm

në fund të vrimës së shpimit duke parandaluar në këtë mënyrë një fluks të padëshiruar (dhe shpesh të rrezikshëm) të lëngjeve të formacioneve. Për të influencuar viskozitetin e lëngut përdoren elementë të ndryshëm trashës, si p.sh. rrëshirë ksantan, rrëshirë guar, celulozë karboksimetil (CMC), celulozë polianionike (PAC), ose niseshte. Nga ana tjetër, deflokulatorët përdoren për të reduktuar viskozitetin e baltave me bazë argjile; polielektrolite anionike (p.sh. akrilate, polifosfate, ose linjosulfonate). Disa aditivë të tjerë të zakonshëm janë lubrifikantët, agjentët frenues të shistit argjilor, si dhe aditive për humbjen e fluideve (për të kontrolluar humbjen e lëngjeve të shpimit në formacionet përshkueshme). Bentonitet, në sasi relativisht të vogla të cilat qëndrojnë pezull në ujë formojnë një material viskoz pseudoplastik. Në përqëndrime mjaft të larta, suspensionet bentonite fillojnë të marrin vetitë e një xheli dhe ndihmojnë në formimin e shtresave të baltës në muret e vrimës së shpimit.

Lëngjet e Shpimit Polimer KCl

Për të stabilizuar formacionet shistit argjilor për shkak të problemeve që lidhen me fryrje të argjilës përdoret një sistem balte kloride kaliumi. Përfitimet e përdorimit të kësaj lloji balte shpimi përfshijnë parandalimin e fryrjes së argjilës, hidratimin e argjilës, çështjet e lidhura me vrimat e ngushta dhe mbushjes së tepërt të puntos, si dhe parandalimin që ajo bën për spastrimin e tepërt dhe baltëzimin e vrimës së pusit.

Aditivët Kimikë

Kimikatet që i shtohen baltës së shpimit i japin asaj veti të veçanta për seksionet e shpimit të pusit në thellësi të ndryshme. Lëngu i shpimit dhe mbetjet e ngurta të shpimit në çdo fazë të shpimit do të kalojnë në pajisjet në kuvertë për trajtimin dhe heqjen e pjesëve të ngurta, të përbërë nga ekstraktues (scalpers), sitat e shistit argjilor, heqësit e gazit (de-gazues), dhe centrifugët dhe më pas mbetjet e ngurta të shpimit do të hidhen në Kazanë të Mbetjeve të Ngurta të Shpimit dhe dërgohen në tokë për trajtim të mëtejshëm dhe asgjësim. Lëngjet e shpimit të rifituara do të ri-injektohen në pus pas trajtimit të nevojshëm për të ruajtur vetitë e tyre. Balta e shpimit do të ruhet në tankera të dedikuara brenda njësisë së shpimit

Lëngjet larës me bazë naftë mund të jenë me diezel, vajguri, solar ose vaj mineral. Këto lëngje larës janë me kosto të lartë por kanë avantazh shpejtësinë e lartë të shpimit, më pak sforcime të instrumentit (tubove) të shpimit, më pak mbathje të datës (ngjitje të copërave të formacionit të shpuar në daltë) dhe më pak ngjitje të instrumentit (tubove) të shpimit për shkak të vetive të formacioneve. Ato janë përdorur në situata në ato raste ku temperaturat e larta në pus dehidratojnë lëngjet larës me bazë ujë ose ku ka formacione të tretshme (kripë).

Një sistem lëngu larës me KCl përdoret për të stabilizuar formacionet shistore për shkak të bymimit të tyre. Përfitimet e përdorimit të këtij tipi lëngu larës përfshijnë evitimin e bymimit të argjilave, hidratimin e argjilave, problemet e ngushtimit të trungut të pusit dhe mbathjet e datës (ngjitja e copërave të formacionit të shpuar në daltë), gjithashtu parandalon kavërimin e trungut të pusit dhe shëmbjet e tij.

Materialet për Ngadalësimin e Qarkullimit

Materialet për ngadalësimin e qarkullimit mund të përdoren edhe në qoftë se zvogëlohet integriteti i formacionit dhe vëllimi i baltës së shpimit ulet në masë të konsiderueshme. Materialet për ngadalësimin e qarkullimit mund të përfshijnë:

- Bentonite, të cilat do të mbyllin vrima apo thyerje të vogla. Bentonitet, në përqëndrime të larta, rrisin viskozitetin dhe për këtë arsye ngadalëson rrjedhën e lëngut në shkëmbin përreth. Megjithëse bentonitet janë shtuesi më i zakonshëm i përdorur, efekti i tyre varet nga lloji i lëngut të përdorur dhe thellësia e shpimit ne raport me zonat e dëshiruara të prodhimit.
- Polimeret përdoren për rritjen e viskozitetit të baltës së shpimit. Megjithëse këto janë më të kushtueshmet, ato janë më të pajtueshme me disa lloje të sistemeve të fluideve.
- Aditivë të tjerë të cilat fizikisht mbyllin ose ngjisin formacionin mund të përfshijnë: tallash, copa të vogla celofani (flaked cellophane), dhe gips i grimtuar ose bluar, gazeta të copëtua (shredded) dhe bohçe të farave të pambukut.

Te gjitha llojet e kimikateve qe magazinohen jane te ambalazhuara ne thas kur ndodhen ne gjendje te ngurte ,dhe ne depozita plastike kur jane ne gjendje te lenget.



Sistemohen mbi paleta druri dhe jane te shoqeruara me etiketa ku tregohet emri, funksioni dhe perdorimi. Sipas Ligj nr. 9108 date 17.07.2003 Substancat dhe preparatet kimike , Importuesit janë të detyruar të regjistrojnë llojin, sasinë, vetitë e substancës dhe të preparatit.

- **Pershkrim i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti, shoqeruar dhe me fotografi**

Per nga origjina , perberja dhe vecorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocenit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket vecorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te

saj, janë karakteristike edhe për bimesinë e vendit tonë. Por kushtet konkrete të zhvillimit, sidomos të klimës dhe të relievit kanë përcaktuar edhe vecorit origjinale të floras së Shqipërisë. E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet vecorit të evolucionit paleogeografik të Shqipërisë dhe sidomos larmisë së madhe të klimës, copetimit të theksuar të relievit dhe formave të shumëllojshme të tij, formacioneve të shumta shkëmbore (gelqerore, magmatike, terrigjene) etj. Fitocenozat e bimesisë barishtore shumë të larmishme nga perberja e llojeve, gjenden në të gjitha zonat fitoklimatike të Shqipërisë. Megjithatë fitocenozat barishtore nga ana e fizionomisë në përgjithësi duken relativisht të përafërta, ato ndryshojnë midis tyre nga perberja floristike në varesi të faktoreve ekologjike. Me përjashtime të pakta, gati në të gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden përfaqësues të familjes graminore (Graminaceae).

Tokat aluvionale mbulojnë territoret fushore, janë më të përhapura përreth rrjedhjeve të poshtme të lumenjve Ishëm, Erzen dhe rrjedhjeve të tjera ujore si dhe në bregdet. Pranë shtretërve të lumenjëve, tokat aluvionale janë të lehta e të imëta (rëra, surargjila), ndërsa larg tyre ato bëhen më të trasha e më të rënda (argjila etj). Pranë bregut të detit tokat aluvionale zëvendësohen nga ranishtet, ku proceset pedogjenike janë shumë të dobëta. Këto toka janë shumë të varfra dhe përdoren kryesisht për mbjelljen e drurëve pyjorë (pisha, plepi i bardhë). Në përgjithësi tokat aluvionale në këtë hapësirë janë mesatarisht të thella dhe shumë pak të cekëta dhe të thella, me ndërtim shtresor. Karakterizohen si toka të thata dhe pjesërisht të freskëta në periudhën e ngrohtë të vitit, ndërsa gjatë stinës së dimrit mbajnë shumë lagështirë, kanë pH neutral me variacione acide dhe bazike të pakta. Përmbajtja me azot është e mesme në 60-70% të tyre dhe e varfër në 30-40% , po në të njëjtën përqindje është dhe përmbajtja e fosforit. Tokat aluvionale kanë pak lëndë organike dhe humus (deri në 2%). Tokat e kripura, përhapjen më të madhe e kanë në zonën e Porto Romanos (ish kënetë e Durrësit) dhe për shkak të përmbajtjes së kripës, nuk janë vënë plotësisht në shfrytëzim bujqësor.

Mbulesa bimore është relativisht e varfër në territoret fushore dhe e pasur në ato kodrinore. Mungesa e bimësisë në zonat fushore, shpjegohet me zhdukjen e bimësisë higrofitë nga veprimtaria ekonomike për sigurimin e tokave bujqësore. Por krahas shyllëzimeve, gjatë periudhës komuniste janë bërë pyllëzime duke krijuar blloqe dhe masive pyjore, siç janë brezi i pishave të buta përgjatë bregdetit të gjirit të Lalëzit dhe sipërfaqet e pyllëzuara me pisha mesdhetare.

Karakteristikat gjeologjike

Bazuar në Hartën të Gjeologjike të rajonit, zona e projektit ndodhet në zonën strukturore të Ultësirës Pranë Adriatike (UPA). Ndërtimi gjeologjik i kësaj zone përfaqësohet kryesisht nga depozitimet e Kuarternarit në sipërfaqe dhe nga depozitimet e Pliocenit më në thellësi. Depozitimet e Kuarternarit përfaqësohen nga depozitimet aluviale proluviale, aluviale dhe detare.

Depozitimet e Pliocenit (N2)

Depozitimet Pliocenike përhapen gjerësisht në Ultësirën Adriatike. Depozitimet e Pliocenit marrin pjesë në ndërtimin e strukturave neogjenike të Durrësit si dhe të disa strukturave të tjera në det. Nga ana litologjike këto depozitime përfaqësohen nga dy pako me karakteristika të ndryshme litologjike si në sipërfaqe dhe thellësi, që vendosen me njëpasnjëshmeri normale me njëra tjetrën. Brenda trashësisë së plotë Pliocenike në Ultësirën Adriatike veçohen dukshëm dy formacione litostratigrafike të njohura me emertimet formacioni “Helmasi” dhe “Rrogzhina”.

Studimet biostratigrafike të kryera kanë saktësuar përkatësinë e këtyre formacioneve respektivisht si të Pliocenit të poshtëm dhe Pliocenit të mesëm.

Depozitimet e Pliocenit të poshtëm (Suita Helmasi) (N21h)

Depozitimete e formacionit "Helmasi". fillojnë me shfaqjen në prerje të shtresave ranore dhe konglomerateve, që përcaktojnë dyshtresën e tij dhe njëkohësisht shënojnë praninë e transgresionit pliocenik. Në rajonin e Gjirit të Lalëzit ku shtrihet edhe zona e studimit trashësia e shtresës së konglomerateve të bazës rritet dhe arrin deri në 250m. Mbi shtresat ranorekongomeratike prerja vazhdon me shtresa argjilo-ranore shtresë holle e mesëm deri në praninë e argjilave masive. Ranorët kanë forma shtresore me trashësi nga 4-8 cm deri në 20-30 cm ngjyre hiri të verdhe, të shkrifet me çimentim të dobët. Ata janë kokërrvegjël dhe mesëm, polimineral të tipit kuarcoro-feldshpatik. Argjilat predominojnë në prerje, janë gri hiri deri në të kalterta, të buta deri në kompakte, herë-herë shumë mikore. Konglomeratët përbehen nga zaje të përberjes dhe formave të ndryshme. Takohen zaje të rrumbullakosura e gjysëm të rrumbullakosura me madhësi mesatare 4-10 cm.

Depozitimet e Pliocenit të mesëm (Suita Rrogozhina)(N22r)

Në prerjet e plota të Pliocenit të mesëm përfshihet pjesa me sipërme e formacionit Helmasi dhe tërësisht formacioni "Rrogozhina". Pjesa e sipërme e formacionit "Helmasi" që datohet e moshës së Pliocenit të mesëm, është vazhdimësi normale e prerjes më të vjetër të saj të datuar Pliocen i poshtëm. Në prerje takohen argjila shtresore herë-herë me pamje masive që shpesh ndërthuren me paketa argjilo-ranore ritemhollë me trashësi shtresash 4 - 8 cm, si dhe me ndërshtrësia alevrolitesh dhe ranoresh me trashësi 15-50 cm. Më rrallë takohen shtresa të holladhe thjerëza mergelore. Në argjilat mbizotëron montmorilloniti dhe me pak iliti, kloriti, kaolini. Depozitimet e formacionit "Rrogozhina" vendosen mbi pakon argjilore të formacionit "Helmasi" në marrëdhënie normale me të. Në sipërfaqe këto formacione takohen me të gjitha karakteristikat litologjike e tyre. Ranorët janë kokërrvegjël deri kokërtrashë shpesh gravelitike, poliminerales, të tipit kuarcoro-feldshpatik me përmbajtje serpentinas. Në përgjithësi ranoret si dhe alevrolitet përmbajnë koncentracione të larta të metalorëve të epidotit, granateve, amfiboleve. Në konglomeratet takohen zaje të rrumbullakosur dhe gjysëm të rrumbullakosur të shkëmbinjve magmatike dhe sedimentare.

Depozitimet detare

Depozitimet detare dalin në sipërfaqe pranë vijës bregore deri në disa qindra metra në drejtim të tokës. Këto depozitime kanë trashësi nga disa metra deri në 100m në drejtim të detit. Përfaqësohen kryesisht nga rera të madhësive të ndryshme. Me depozitimet detare janë të lidhura dhe shkrifërimet detare të plazheve të sotme, por ato takohen edhe të mbuluara në brendësi të kontinentit.

Aktiviteti i magazinimit tekimikateve nga shoqëria do të zhvillohet në magazine ekzistuese, pra është e ndertuar. Ambjentet e cilin shoqëria e ka marrë me qira.

-Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te tij

Shqipëria është shumë e pasur me ujera nentokesore. Kjo lidhet me shumë faktore, por rol të madh sigurisht luajnë sasia e madhe e reshjeve dhe shumëllojshmëria e formacioneve shkëmbore, në të cilat përhapje të madhe kanë formimet karbonatike të pershkueshme nga uji.

Bashkia e Durrësit shtrihet përgjatë bregut të detit Adriatik nga grykëderdhja e lumit Ishëm në veri deri në kufi me Kavajën në jug. Vija e gjatë bregdetare që i shtohet qytetit të Durrësit e thekson tiparin e kesaj bashkie si zonë turistike, pasi përveç plazhit të Durrësit asaj i shtohet i gjithë gjiri i Lalezit si dhe Kepi i Rodonit, të cilat deri tani kanë qenë pjesë e komunave.

Vija bregdetare me gjatësi 62 km ofron plazhe të shumta si dhe disa vende natyrore për porte. Plazhi i Durrësit, me gjatësi 7 km, i shtrirë nga Ura e Dalanit deri tek Prroi i Agait, përfaqëson sot destinacionin më të rëndësishëm të turizmit për Shqipërinë. Me rërën e butë e të bardhë, thellësinë graduale të detit, me mbi 100 hotele të cilësisë si dhe qindra apartamente, ai arrin të presë rreth 150 mijë pushues, vendas e të huaj, në ditët e pikut të tij. Dy zona të virgjëra bregdetare presin zhvillime të reja: zona Kallmet- Porto Romano, rreth 5 km e gjatë dhe ajo e Ishmit, rreth 15 km. Studimet e bëshëmërisë së këtyre zonave kanë ngjallur interesin e investitorëve vendas dhe të huaj, të prirë ndaj turizmit të klasit të mesëm dhe atij elitari.

Aktiviteti do të zhvillohet në objekt ekzistues prandaj gjatë shfrytëzimit nuk do të cënohen rrugët ujore, brigjet lumenjtë, dhe bregdetet etj. Zona kushtrihet aktiviteti ka qenë zonë kenetore. Si rezultat i bonifikimit kjo zonë pershkohet nga një rrjet i dendur kanalesh kulluese të cilët mbledhin ujerat sipërfaqësore dhe nentokesore.

- Informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme negative në mjedis të projektit përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër

Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim mjedisor të matshëm pasi:

- Nuk ka prodhim të mbetjeve të rrezikshme
 - Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në ndryshimin e nivelit të ujrave tokësore, në rrugët ujore dhe në nivelin hidrostatik të ujrave nëntokësore, pasi në këtë zonë ku ndodhet objekti dhe përreth tij nuk ka burime ujore nëntokësore dhe shpime të ndryshme hidrogeologjike që do të mund të dëmtoheshin nga ky aktivitet.
 - Nuk shkakton ndotje të tokës me shkarkime të ndryshme të lëngëta apo të ngurta.
 - Ushtrimi i këtij aktiviteti nuk do të ndikojë në cilësinë e ajrit të zonës, pasi nuk do të ketë shkarkime në ajër të gazrave, pluhurave apo tymrave.
 - Gjatë ushtrimit të këtij aktiviteti nuk do të ketë emetime të ndryshme kimike të llojeve të ndryshme.
 - Nuk parashikohen dëmtime të florës dhe faunës së zonës.
 - Zhurmat në mjediset e punës janë brenda normës të lejuar, dhe për pasojë as zhurmat në mjediset e jashtme nuk pritet të kenë ndikim në popullatën përreth.
- Niveli i zhurmës nuk i kalon 55-70 dB(A) gjatë punës në këte magazine. Ky nivel zhurmash është brenda normave dhe nuk ndikon në shëndetin e punonjësve.

- Ka vlera normale të temperaturës dhe të lagështisë në mjediset e punës
- Janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen në punë nga aksidentet dhe për evitimin e rrezikut nga zjarri.
- Fenomene të tjera. Vibracioni, nxehtësia, radiacioni, ndriçimi verbues etj. nuk janë të pranishme.

- **Nje pershkrim per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime si dhe per prodhimin e mbetjeve**

Aktiviteti konsiston vetem ne magazinimin e kimikateve si vijne nga importi dhe me pas tregtimin e tyre. Duke qen se nuk kemi te bejm me aktivitet prodhues nuk ka ndikim ne ujera, ajer apo toke. Dyshemeja e magazines eshte e shtruar me beton dhe nuk ka depertim te kimikateve ne toke ne raste aksidentale te demtimit te amballazhimeve.

Zhurmat kryesisht do te krijohen nga levizja e automjeteve. Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe. Çdo burim perhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit.

Energjia zvoglohet per gjate rruges si rezultat i absorbimit te siperfaqeve, divergjences gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Program i perdorur per llogaritjen e nivelit te zhurmave merr parasysh faktori

“A” – niveli i presionit te zhurmes te llogaritur

Faktori « A » perbehet nga kontribuesit qe vijojne

Niveli i fuqise se zhurmes ne drejtim te perhapjes $L_{ne\ drejtim\ te\ eres}$, llogaritet per cdo burim

$$L_{ne\ drejtim\ te\ eres} = L_{W_} - A$$

Niveli i zhurmave te ketyre automjeteve, eshte i atij niveli qe nuk influencon si per te punesuarit dhe per banoret dhe gjallesat per rreth tij. Fenomene te tilla si vibracion zhvillimi i aktivitetit nuk do te kete.

Mbetjet qe krijohen do te jene vetem mbetje me karakter urbane nga aktiviteti i perditshem i punonjesve. Keto mbetje do te grumbullohn ne kosha plastike dhe me pas do te depozitohen ne vendin e caktuar nga bashkia Durres.

- **Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara**

Gjate fazes normale te zhvillimit te projektit nuk do te kete emetime te gazeve, lengjeve, mbetjeve toksike, helme te ndryshme dhe substanca te tjera te demshme, te cilat mund te ndikojne negativisht ne shendetin e punonjesve, banoreve dhe mjedisin perreth, floren dhe faunen e zones, burimet ujore.

Aktiviteti qe do te zhvillohet konsiston ne magazinimin e kimikateve. Kohezgjatja e zhvillimit te aktivitetit nuk eshte percaktuar nga investitori, sepse kjo varet edhe nga kerkesat per perdorimin e ketyre kimikateve.

- **Te dhena per shtrirjen e mundshme hapësirë të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të**

Identifikimi i ndikimeve – Përmes të cilit u përcaktua ndërvëprimi mjedis-projekt i aktivitetit u identifikuan ndikimet e mundshme gjatë kësaj faze sipas receptoreve të mjedisit.

Vlerësimi i ndikimeve – Ekspertët mjedisorë të fushave të ndryshme bëjnë përpjekje për matjen e gravitetit të ndikimeve . Vlerësimi i Sinjifikances ka të bëjë me vete rëndësinë e ndikimeve dhe është faza më e rëndësishme për zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe përfaqëson atë me objektivisht me tërësinë e bashkëveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e përdorur për vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve variojnë dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit të ndikuar.

Shtrirja fizike- Vlerëson sipërfaqen apo dimensionin hapësirë të një ndikimi të dhënë në raport me burimin që gjeneron atë ndikim, p.sh. ndikimi në tokë nga shfrytëzimi është një ndikim saktësisht i përcaktuar i cili mund të matet , por nëse do të ketë erozion të tokës ndikimi rritet në përmasa fizike të sipërfaqes së marrë për studim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlerëson se sa do të zgjase një ndikim i caktuar në dimensionin kohë (ndikim i përhershëm apo i përkohshëm). Në rastin tonë zhvillimi i aktivitetit është për një afat kohor të caktuar sipas programit të punimeve.

-**Kthyeshmëria** –Vlerëson mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar në gjendjen e tij të mëparshme (aftësia për tu rehabilituar dhe regjeneruar)

-**Rëndësia** – Realizon një vlerësim total të tre përmasave të mësipërme dhe njëkohësisht thekson vëmendjen që duhet patur për administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kanë shtrirje të mëdha fizike, magazinimi i kimikateve nuk ka ndikime negative në zonë. Zhurmat që krijohen nga levizja e mjeteve furnizuese nuk përbejnë ndotje akustike. Analiza e frekuencës të zhurmës të emetuar nga këto mjete tregon se ato ndodhen nën mesataren e frekuencës 100 – 150 Hz , e cila është e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha në të cilën do të jenë të pranishme këto zhurma është vetëm gjatë furnizimit të magazines me kimikate. Niveli i zhurmave të këtyre mjeteve në largësi nuk do të jetë i madh dhe do të jetë konform normave në fuqi.

- **Mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin**

Aktiviteti zhvillohet në kushte tëper të mira ,higjienike dhe të këndshme estetike. Është kryer një menaxhim i mirë i të gjithë hapësirës së sipërfaqes duke u gjelberuar ,duke ushtruar me beton me lluster për izolimin e filtrimeve të mundshme.

Duke qen terren fushor jane ndertuar te gjitha sistemet e kanalizimeve dhe te drenazhimit te zones. Nuk eshte prekur nga permbytjet ,nuk eshte vleresuar si zone me rrezikshmeri per shkaqe natyrore. Ne rast te mbylljes se aktivitetit , rehabilitimi do te perfshij largimin e kimikateve ,pastrimin e magazines e cila mund te perdoret per aktivite te tjera nga subjekti i cili e ka ne pronesi.

- **Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis**

Me qellim qe te parandalohen , shmangen minimizohen dhe kontrollohen ndikimet negative mjedisore te aktivitetit gjate zhvillimit te tij, investitori duhet te marr masat e duhura per mbrojtjen e mjedisit.

Te gjitha llojet e kimikateve qe magazinohen jane te ambalazhuara ne thas kur ndodhen ne gjendje te ngurte (Pluhur) ,dhe ne depozita/fuci plastike kur jane ne gjendje te lenget. Sistemohen mbi paleta druri dhe shoqeria regjistron llojin, sasinë, vetitë e substancës dhe të preparatit. Dyshemeja e magazines eshte e shtruar me beton ne menyre qe te mos kete ndotje te tokes ne raste aksidentale te rrjedhjes se kimikateve.

- **Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)**

Aktiviteti zhvillohet brenda territorit te vendit tone dhe nuk ka ndikime ne mjedisin nderkufitar.